



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2020:020998

Datë: 23.10.2025

Numri i dokumentit: 07942679

K.DH.SH.II.nr.1562/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarët Fisnik NULI, kryetar i kolegjit, Ramush BARDIQI dhe Krenar BERISHA anëtarë në çështjen juridike të paditësit N.SH “Grand Media”, me seli në Zonën Industriale, Prishtinë, me NRB 702268875, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Korab Rexhepi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Radio Televizioni i Kosovës, me seli në rrugën Xhemail Prishtina, nr.12, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Diamant Zekaj, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,963.751.32 €, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr. 372/24 të datës 05.06.2024, në seancën e kolegjit më mbajtur me datë 16.10.2025, morri këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e paditësit N.SH “Grand Media” me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr. 372/24 i datës 05.06.2024, ashtu që çështja gjykohet si në vijim:
- II. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.SH “Grand Media” me seli në Prishtinë, dhe DETYROHET i padituri Radio Televizioni i Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit N.SH “Grand Media” me seli në Prishtinë të ia paguaj: në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e ndërprerjes/shkëputjes së njëanshme të kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit “kush do të bëhet milioner” shumën prej 340,808.00€, në emër të detyrimit kontraktues sipas kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit “kush do të bëhet milioner” për emisionet e prodhuara dhe të transmetuara shumën prej 32,933.54€, si dhe në emër të detyrimit kontraktues sipas kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit “kush do

të bëhet milioner”, për emisionet e prodhuara por të pa transmetuara shumë prej 408,969.60€ gjithsej shumë e përgjithshme në vlerë prej 782,701.54€ (shtatëqind/e/tetëdhjetë/e/dy/mijë/e/shtatëqind/e/një/euro/e/pesëdhjetë/e/katër/cent) me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në Bankat Komerciale me afat mbi një vit, të llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, me datën 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

- III. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit N.SH “Grand Media” me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Radio Televizioni i Kosovës me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit të shkaktuar - fitimit të humbur si pasojë e mos-përmbushjes së kontratës mbi emetimin televiziv, të ia paguaj paditësit shumë prej 930.973.54 € si dhe në emër të fitimit të humbur nga marketingu dhe sponsorët shumë prej 250,066.64 €, gjithsej shumë e përgjithshme në vlerë prej 1,181,040.18€, të gjitha me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- IV. DETYROHET i padituri Radio Televizioni i Kosovës me seli në Prishtinë që paditësit N.SH “Grand Media” me seli në Prishtinë t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë e përgjithshme prej 7,251.50€ (shtatë/mijë/e/dyqind/e/pesëdhjetë/e/një/euro/e/pesëdhjetë/cent), në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- V. REFUZHET si e pa bazuar ankesa e të paditurit Radio Televizioni i Kosovës me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike dhe ta njohë vlerën e borxhit real prej 32,934.52€ e cila tregohet edhe në bazë të pasqyrës financiare të RTK-së, për të cilën pala e paditur i obligohet paditësit.

A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktgjykimin KE.nr.1664/23 të datës 19.04.2024, ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.SH “Grand Media”, dhe DETYROHET i padituri Radio Televizioni i Kosovës, që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së kontratës nr. 1283/11, të ia paguaj paditësit shumë prej 340,808.00 €, si dhe në emër të borxhit shumë prej 32,933.54 €, gjithsej

shumën e përgjithshme në vlerë prej 373,741.54 € (treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e katër dhjetë e një euro e pesëdhjetë e katër cent) me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në Bankat Komerciale në periudhë kohore prej një viti, të llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, me datën 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

- II. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit N.SH “Grand Media”, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Radio Televizioni i Kosovës, që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së kontratës nr. 1283/11, të ia paguaj paditësit në emër të fitimit të humbur shumën prej 1,339.943.14 € si dhe në emër të fitimit të humbur nga marketingu dhe sponsorët shumën prej 250,066.64 €, me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- III. DETYROHET i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 6,962.50 € (gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy euro e pesëdhjetë cent), në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjorë ankesë të pjesshme ka paraqitur paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të I. aprovohet e bazuar ankesa e paditësit N.SH. Grand Media me numër të regjistrimit të biznesit 70226875, me seli në adresën Zona Industriale Prishtinë, përfaqësuar nga avokati Korab Rexhepi nga Prishtina, II. Ndryshohet pika II e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KE. Nr. 372/24 të datës 05.06.2024, ashtu që detyrohet i padituri Radio Televizioni i Kosovës, që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së kontratës Mbi emetimin televiziv të ia paguaj paditësit në emër të fitimit të humbur shumën prej 1,339,943.14 €, si dhe në emër të fitimit të humbur nga marketingu dhe sponsorët shumën prej 250,066.64 €, në shumë të përgjithshme prej 1,590,009.78€, si dëmshpërblim për mos përmbushje të kontratës, me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8% duke filluar nga data 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, dhe III. Detyrohet i padituri që t’ia paguaj shpenzimet për përpilimin e kësaj ankese në vlerë prej 325€ në total shumën prej 7,251.5€ në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjorë ankesë ka parashtruar edhe i padituri Radio Televizioni i Kosovës për shkak të : konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike dhe ta njohë vlerën e borxhit real prej 32,934.52€ e cila tregohet edhe në bazë të pasqyrës financiare të RTK-së, për të cilën pala e paditur i obligohet paditësit.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195 dhe 201 të Ligjit për Procedurën Kontestimore LPK, ka gjetur se:

- Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar, ndërsa
- Ankesa e të paditurit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës, respektivisht nga padia rezulton se paditësi N.SH “Grand Media”, me datën 28.05.2014, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për mos përmbushjen e kontratës nr. 1283/11 për transmetimin e emisionit “Kush do të bëhet Milioner”, kundër të paditurit Radio Televizioni i Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditësit të ia paguaj shumën prej 1,463.117.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Me datën 29.03.2016 dhe 11.07.2016 paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke kërkuar që të detyrohet i padituri që paditësit në emër të dëmit material të ia kompensoj shumën e përgjithshme në vlerën prej 3,402.637.00 €.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin III. EK.nr.541/15 të datës 09.03.2018, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të paditurin Radio Televizioni i Kosovës – RTK, që paditësit N.SH “Grand Media”, të ia paguaj shumën prej 482,813.54 €, në emër të borxhit për periudhën kohore prej

01.05.2012 deri me datën 31.12.2012, për shkak të emitimit-transmetimit të emisioneve sipas kontratës së datës 14.02.2011, si dhe në emër të dëmshpërblimit shumë prej 1,344,065.00 €, gjithsej në shumë prej 1,826.878.54 €, me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim, me afat mbi 1 vit, e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 28.05.2014, të gjitha këto në afatin prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, sa i përket shumës prej 500,000.00 €, në emër të dëmtimit të imazhit. Në pikën III të dispozitivit është vendosur që shpenzimet e procedurës kontestimore, ti bartë secila palë veç e veç.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës së paditur, me aktvendimin Ae.nr. 127/18 të datës 03.02.2020, e ka aprovuar ankesën e të paditurës si të themeltë dhe ka prishur aktgjykimin III.EK.nr.541/15 të datës 09.03.2018 të gjykatës së shkallës së parë dhe të njëjtën çështje e ka kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin KE.nr 829/22 të datës 18.08.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.SH “Grand Media”, dhe e ka detyruar të paditurin Radio Televizioni i Kosovës, që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së kontratës nr. 1283/11, të ia paguaj paditësit shumë prej 340,808.00 € dhe në emër të borxhit shumë prej 32,933.54 €, gjithsej shumë e përgjithshme në vlerë prej 373,741.54 € (treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e katër dhjetë e një euro e pesëdhjetë e katër cent) me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në periudhë kohore prej një viti, të llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, me datën 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit N.SH “Grand Media”, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Radio Televizioni i Kosovës, që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së kontratës Mbi emetimin televiziv, të ia paguaj paditësit në emër të fitimit të humbur shumë prej 1,339.943.14 € si dhe në emër të fitimit të humbur nga marketingu dhe sponsorët shumë prej 250,066.64 €, me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Në pikën III të dispozitivit është detyruar i

padituri që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të ia paguaj paditësit shumën prej 6,215.00 €.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 1664/23 të datës 19.04.2024, i ka aprovuar si të bazuara ankesat e paditësit dhe të paditurit, e ka prishur Aktgjykimin KE.nr 829/22 të datës 18.08.2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë dhe të njëjtën çështje e ka kthyer përsëri në rigjykim dhe vendosje, duke marr numrin e ri të lëndës KE.nr 372/24.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin KE.nr 372/24 të datës 05.06.2024, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.SH “Grand Media”, dhe e ka detyruar të paditurin Radio Televizioni i Kosovës, që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së kontratës nr. 1283/11, të ia paguaj paditësit shumën prej 340,808.00 € dhe në emër të borxhit shumën prej 32,933.54 €, gjithsej shumën e përgjithshme në vlerë prej 373,741.54 € (treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e katër dhjetë e një euro e pesëdhjetë e katër cent) me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në periudhë kohore prej një viti, të llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, me datën 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit me detyrim. Në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të të kërkesëpadisë së paditësit N.SH “Grand Media”, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Radio Televizioni i Kosovës, që në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së kontratës Mbi emetimin televiziv, të ia paguaj paditësit në emër të fitimit të humbur shumën prej 1,339.943.14 € si dhe në emër të fitimit të humbur nga marketingu dhe sponsorët shumën prej 250,066.64 €, me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Në pikën III të dispozitivit është detyruar i padituri që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të ia paguaj paditësit shumën prej 6,215.00 €.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka konstatuar se në rastin konkret i padituri në mënyrë të njëanshme pa ndonjë arsye dhe pa paralajmërim ka shkëputur kontratën me paditësin, andaj edhe është krijuar baza ligjore për kompensimin e dëmit të pësuar, që ka

rezultuar si pasojë e shkëputjes së njëanshme dhe në kundërshtim me Ligjin dhe dispozitat kontraktuese të Kontratës nr. 1283/11, për arsyet në vijim:

Sipas nenit 14 të Kontratës mbi emetimin televiziv të lidhur ndërmjet Radio Televizionit të Kosovës në cilësinë e emetuesit dhe Grand Media në cilësinë e shtëpisë prodhuese është përcaktuar shprehimisht që *“Shtëpia Prodhuese pajtohet : Emituesi RTK është televizioni publik dhe nuk është i garantuar me buxhet financiar afatgjatë, dhe në rast se RTK vjen me ndonjë problem kur ndërpriten totalisht të hyrat financiar atëherë RTK për këtë periudhë nuk merr përsipër obligimet ndaj Shtëpisë Prodhuese, Emituesi merr për obligim të njoftojë me shkrim Shtëpinë Prodhuese dhe në këtë rast palët mund të marrin një vendim për ndërprerje të emitimit vetëm gjatë kohës sa RTK nuk ka të siguruar buxhetin financiar, kjo mund të bëhet menjëherë me Aneks Kontratë. Palët Kontraktuese me marrëveshje, konstatojnë që me këtë kontratë të konkretizojnë bashkëpunimin afarist lidhur me prodhimin me emetimin e emisionit lëndor në këtë kohë të caktuar për periudhën nga 14 Shkurt 2011 deri 13 Shkurt 2016. Kontrata nuk mund të ndërprehet para afatit të paraparë nga njëra palë pa ndonjë arsye, vetëm me anë të marrëveshjes nga dy palët kontrata mund që me marrëveshje të ndërpritet në çdo kohë duke i definuar në mënyre precize të drejtat në mes tyre dhe obligimet që paraqiten deri në momentin e ndërprerjes së kontratës. Në rast se njëra palë ndërprente bashkëpunimin njëanshëm pa ndonjë arsye të mos respektimit të kësaj marrëveshje atëherë si dëmshpërblim duhet të paguaj shpenzimet pesë (5) mujore. Secila palë kontraktuese mund njëanshëm ta ndërpresë kontratën në rast se pala tjetër kontraktuese nuk i plotëson obligimet e marra me kontratë me atë që në rast të përcaktimit të njëanshëm të ndërprerjes së kontratës, afati i ndërprerjes së kontratës të zgjasë 90 ditë dhe fillon të rrjedhë nga dita e dërgimit të kërkesës për ndërprerje të njëanshme të kontratës në formë të shkruar”.*

Gjykata e shkallës së parë, për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, përveç provave të administruara si në aktgjykimin e ankimuar, është bazuar edhe në nxjerrjen e provave me anë të ekspertizave financiare, e nga të cilat është konstatuar gjendja si në vijim:

Nga Ekspertiza financiare e datës 10.08.2016, e punuar nga eksperti financiar Riza Blakaj, është konstatuar që mbi bazën e përllogaritjeve të bëra:

- Sipas variantit të parë, i cili i referohet periudhës prej ndërprerjes së emitimit të emisioneve televizive: 01.05.2012 – 31.12.2012 dhe borxhit paraparak, dëmit të shkaktuar

si pasojë e mos emitimit të 24 emisioneve, fitimit të humbur mbi atë bazë, për shkak të pamundësimit të angazhimit të sponsorit për emetimin e reklamave, obligimi i palës së paditur ndaj palës paditëse është në shumën prej 482,813.54 €.

- Sipas variantit të dytë i cili i referohet periudhës prej ndërprerjes së emitimit të emisioneve televizive: 01.05.2012 – 13.02.2016 dhe borxhit paraprak, dëmit të shkaktuar si pasojë e mos emitimit të 24 emisioneve, fitimit të humbur, për shkak të pamundësimit të angazhimit të sponsorit për emetimin e reklamave obligimi i palës së paditur ndaj palës paditëse është në shumën prej 1,826.878. 54 €.

Nga super ekspertiza financiare e punuar nga grupi i ekspertëve në përbërje prej 1. Flamur Keqa, 2. Remzi Ismajli dhe 3. Gresa Shabani e datës 30.09.2021 është konstatuar që :

- dëmi material i llojit të fitimit të humbur për obligimet pesë mujore të paditësit sipas nenit 14 të kontratës arrin në vlerën prej 340.808,00. € dhe borxhi i mbetur në emër të faturave të pa paguara nga e paditura arrin në vlerën prej 32,933.54 €, ku në total borxhi dhe fitimi i humbur arrin në shumën prej 373,741.54 €.
- ndërsa sipas versionit tjetër duke përfshirë edhe vlerën e 24 emisioneve të pa emituara së bashku me shpenzimet pesë mujore dhe borxhin e hapur shuma totale arrin në vlerën prej 782.701,54 €.

Nga plotësimi i super ekspertizës financiare e datës 20.02.2022 grupi i ekspertëve ka konstatuar që:

- dëmi material i llojit fitimi i humbur për obligimet duke filluar nga data 01.05.2012 e deri në përfundim të kontratës me datën 13.02.2016 arrin shumën prej 1,680,751.14 €;
- dëmi material i llojit fitimi i humbur nga të hyrat e sponsorit Frutex sh.p.k., për periudhën nga data 01.05.2012 deri në përfundim të kontratës me sponsorin me datën 31.12.2015 arrin shumën prej 250,066.64 €,
- ndërsa borxhi i mbetur në emër të faturave të pa paguara nga e paditura arrin vlerën prej 32.933,54 €,
- ku totali i borxhit arrin shumën prej 1,963,751.32 €.

Në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese, duke vlerësuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse, Gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e atakuar, është bazuar në dispozitat

ligjore të LMD-së (1978). Sipas neneve 15 dhe 17 të LMD-së, palët kontraktuese në marrëdhënie kontraktuese janë të obliguara t'i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjëse lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke. Ndërsa sipas nenit 154 të LMD-së, përcaktohet se “ai që shkakton dëmin, është i detyruar ta kompensoj atë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”. Bazuar në këto dispozita edhe paditësi ka qenë i detyruar t'i përmbush obligimet kontraktuese në tërësi ashtu siç është paraparë me dokumentet kontraktuese. Mirëpo, pavarësisht dispozitave të sipër cekura, neni 192 i LMD-së, parasheh se i dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose te jetë më i madh nga sa do të ishte zakonisht, ka të drejtë vetëm për kompensim përpjesëtimisht të pakësuar. Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i dëmtuesit, gjykata do të gjykojë kompensimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit. Ndërsa parimet themelore të së drejtës së detyrimeve të parapara me LMD parashohin se palët në marrëdhëniet detyimore duhet të sillen në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të nderhme dhe nuk lejohet shpërdorimi i te drejtave. Në bazë të këtyre parimeve i dëmtuari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme që pasojat e dëmit të jenë sa më të vogla.

Gjykata e shkallës së parë nga gjendja faktike e vërtetuar, konstaton se kërkesa e paditësit përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, përkatësisht kërkesa për kompensimin e shumës prej 1,339.943.14 €, në emër të fitimit të humbur si rezultat i mos përmbushjes së Kontratës nr. 1283/11 dhe shumës prej 250,066.64 € në emër të fitimit të humbur nga marketingu dhe sponsorët, të gjitha këto për tërë periudhën e kontraktuar nga data 14 shkurt 2011 deri me 13 shkurt 2016, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë e deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit, bie në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës së detyrimeve. Kjo për faktin që palët në marrëdhëniet detyimore duhet të sillen në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të nderhme ku nuk lejohet shpërdorimi i te drejtave. Në bazë të këtyre parimeve i dëmtuari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme që pasojat e dëmit të jenë sa më të vogla. Në rastin konkret në dispozitën e Nenit 14 të kontratës është përcaktuar se Shtëpia prodhuese, në këtë rast paditësi, është pajtuar që Emetuesi RTK në këtë rast i padituri, nuk është i garantuar me buxhet afatgjatë financiar duke paraparë që kontrata mund të ndërpritet në çdo kohë.

Tutje Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimi e ankimuar thekson se në atë rast, i padituri merr përsipër përmbushjen e detyrimeve të krijuara deri në atë kohë, respektivisht pagesën e shpenzimeve 5 mujore, elemente këto në bazë të së cilave paditësi ka qenë i vetëdijshëm se

kontrata mund të shkëputet në çdo kohë dhe pavarësisht se i padituri e ka ndërprerë pranimin e emisioneve dhe pagesave si dhe ka nxjerr procesverbalin “Takimi RTK – Grand Media”, të datës 17.04.2013, me konkluzionin për ndërprerje të kontratës, paditësi nuk ka marrë asnjë veprim që ta ndërpresë shkaktimin e dëmit, por ka vazhduar me prodhimin e emisioneve duke injoruar në tërësi ngjarjet e ndodhura dhe me këtë, në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipër cekura, ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e pasojave të dëmit, respektivisht në zgjatjen e periudhës për të cilën tani kërkon kompensimin e dëmit. Me Nenin 124 të LMD-së, përcaktohet se: “për kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushte parashikuara në nenet e më pastajme, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë në qoftë se zgjidhja e kontratës lind sipas vetë të drejtës, e sidoqoftë ka të drejtë t’i kompensohet dëmi.” Bazuar në dispozitat ligjore dhe kontraktuese të sipër cekura, paditësi ka pasur mundësi të shkëpusë kontratën, për shkak se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e vet, dhe të parandalojë shkaktimin e mëtejme të dëmit, por paditësi me veprimet e tij ka kontribuar që të krijohet dëm më i madh nga sa do të ishte po të ndërmernte veprimet e përcaktuara me ligj dhe me kontratë, me ç’ rast gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për zbatimin e Nenit 192 të LMD-së.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë iu referua edhe nenit 263 të LMD-së, i cili përcakton se: *”Debitori shkarkohet nga përgjegjësia për dëmin në qoftë se provon se nuk ka mundur ta përmbushë detyrimin e vet, respektivisht se ka vonuar me përmbushjen e detyrimit për shkak të rrethanave të krijuara pas lidhjes së kontratës të cilat nuk ka mundur t’i parandalojë, t’i evitojë ose t’iu shmanget”*, gjeti se në rastin konkret nuk është kontestuese se e paditura për shkak të ndryshimeve ligjore të sipër cekura dhe gjendjes financiare nuk ka mundur ta përmbushë detyrimin e kontraktuar për shkak të rrethanave të krijuara pas lidhjes së kontratës. Për më tepër, “Kontrata për Emetimin Televiziv” për nga natyra juridike përbën kontratë të sipërmarrjes (kontratë mbi veprën) e rregulluar me kapitullin e XII të LMD-së. Me nenin 629 të LMD-së, përcaktohet se: *“Gjithnjë gjersa puna e porositur nuk ka marrë fund, porositësi mund të zgjidhë kontratën kurdo që të dëshirojë, por në këtë rast ka për detyrë ti paguajë sipërmarrësit shpërblimin e kontraktuar, zvogëluar për aq sa janë shpenzimet që ky nuk i ka bërë e që do të kishte për detyrë t’i bënte po të mos zgjidhej kontrata, si dhe shumën e fitimin që ka realizuar në anën tjetër ose që ka ometuar me dashje të realizojë”*. Në kuptim të kësaj dispozite, të paditurës i njihet e drejta që njëanshëm, sipas vullnetit të vetë, pa fajin e palës tjetër, ta zgjidhë kontratën derisa puna nuk është kryer në tërësi.

Gjykata e shkallës së parë, kontratën nr. 1283/11, e konsideron si kontratë mbi veprën, dhe thekson se te kontrata mbi veprën porositësi kontraktkon punët apo shërbimet për përmbushjen e nevojave të veta sipas porosive të tij. Prandaj nëse nevojat e tij ndërpriten apo për çfarëdo arsye humb interesin për punët e kontraktuara vazhdimi i zbatimit të kontratës humb qëllimin dhe arsyen për të cilën është lidhur. Megjithatë, edhe pse porositësi i punëve ka të drejtën që ta shkëpusë kontratën kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë që ai mund ta bëjë këtë në dëm të palës tjetër kontraktues – kryerësit të punëve, sepse kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e barazisë së palëve në raportet kontraktuale. Prandaj, kur porositësi i punëve e shkëputë kontratën sipas vullnetit të tij, pa fajin e palës tjetër, detyrohet ta kompensojë dëmin respektivisht ti paguajë sipërmarrësit shpërblimin e kontraktuar, zvogëluar për aq sa janë shpenzimet që ky nuk i ka bërë e që do të kishte për detyrë t'i bënte po të mos zgjidhej kontrata, si dhe shumën e fitimit që ka realizuar në anën tjetër ose që ka ometuar me dashje të realizojë. Duke u nisur nga parimi që në këtë rast edhe kryerësi i punës, si bashkë-kontraktues me mirëbesim duhet t'i ndërmarrë të gjitha veprimet që dëmi të mënjanohet apo të zvogëlohet për aq sa është e mundur, ashtu që në vend të përmbushjes së kontratës të vazhdoj me pranimin e punëve tjera, sepse në atë rast dëmi eventual kompensohet me fitimin nga punët tjera të kryera në atë periudhë apo nga punët të cilat me vetëdije i ka lëshuar.

Në rastin konkret paditësit, mos përmbushja e kontratës nga e paditura nuk ia ka pamundësuar kontraktimin dhe kryerjen e punëve tjera nga veprimtaria e vet, madje nuk ka qenë i penguar që edhe emisionet e prodhuara sipas kontratës t'i shesë shtëpive tjera televizive. Ky qëndrim mbështetet edhe në dispozitën e nenit 273 të LMD-së, e cila përcakton se *“Kur dënimi është kontraktuar për rastin e mos përmbushjes së detyrimit, kreditori mund të kërkojë ose përmbushjen e detyrimit ose dënimin kontraktues. Ai e humb të drejtën për të kërkuar përmbushjen e detyrimit në qoftë se ka kërkuar pagimin e dëmit të kontraktuar”*. Në rastin konkret me Nenin 14 të Kontratës është përcaktuar qartë se: Në rast se njëra palë ndërprente bashkëpunimin njëanshëm pa ndonjë arsye të mos respektimit të kësaj marrëveshje atëherë si dëmshpërblim duhet të paguaj shpenzimet pesë (5) mujore. Prandaj, bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, paditësi ka pasur të drejtën që në mënyrë alternative të kërkojë përmbushjen e kontratës, pagesën e dënimit kontraktues apo shpërblimin e dëmit, ndërsa nuk i njihet e drejta për të kërkuar në mënyrë kumulative edhe përmbushjen e kontratës edhe dënimin kontraktues si dhe kompensimin e dëmit, ashtu siç ka kërkuar më kërkesëpadi. Madje sipas dispozitës së nenit 629 të LMD-së, në rast të kontraktimit të shpërblimit për shkëputje të kontratës, ai ka të drejtën të kërkojë vetëm pagesën e shpërblimit të kontraktuar.

Gjykata e shkallës së parë bazuar në këto dispozita dhe në gjendjen faktike të konstatuar, ka vlerësuar se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar andaj të njëjtën e ka aprovuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjyqimit të ankimuar. Lartësinë e kompensimit, gjykata e shkallës së parë e ka përcaktuar nga ekspertiza financiare e punuar nga grupi i ekspertëve në përbërje prej 1. Flamur Keqa, 2. Remzi Ismajli. dhe 3. Gresa Shabani të datës 30.09.2021 me të cilën është konstatuar që dëmi material për obligimet pesë mujore të paditësit sipas nenit 14 të kontratës arrin në vlerën prej 340.808,00. € si dhe detyrimi i mbetur në emër të faturave të pa paguara nga e paditura arrin në vlerën prej 32,933.54 €, ku në total detyrimi kontraktues dhe fitimi i humbur arrin në shumën prej 373,741.54 €, të cilës ekspertizë gjykata e shkallës së parë ia fali besimin sepse konstatimet e grupit të ekspertëve përputhen në tërësi edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit mbi shumën e gjykuar dhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të aktgjyqimit të ankimuar, pasi ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit mbi shumën e aprovuar është e pabazuar në ligj. Po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk e ka marr parasysh plotësimin e ekspertizës financiare të grupit të ekspertëve të datës 20.02.2022, meqenëse në rastin konkret paditësit ia ka njohur të drejtën e kompensimit të dëmit, vetëm për shpenzimet pesë mujore të përcaktuara në nenin 14 të Kontratës, e të cilat kanë qenë të llogaritura në ekspertizën e datës 30.09.2021 të punuar nga grupi i ekspertëve.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK e vlerësoi aktgjyqimin e gjykatës së shkallës së parë, brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Dhoma e Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate, kanë gjetur se aktgjykimi i atakuar është marrë pjesërisht me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se gjykata e shkallës së parë edhe pse i ka vlerësuar të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur pjesërisht në konkludime të gabueshme lidhur me gjendjen faktike, duke bërë interpretim të gabueshëm të disa fakteve të vërtetuara dhe duke i injoruar në tërësi disa fakte të tjera që i referohen emisioneve të prodhuara nën kontratën mbi emetimin televiziv, në fuqi e të cilat fare nuk janë transmetuar me vendim të njëanshëm të të paditurit dhe se për të njëjtat emisione janë refuzuar edhe faturat, dhe mbi këtë bazë kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e

paditësit duke u bazuar vetëm në deklaratimet e përfaqësuesit të të paditurës dhe duke u thirrur gabimisht edhe në dispozitat materiale të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, lidhur me këtë pjesë.

Kolegji i ka vlerësuar përfundimet e tilla të gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik nuk mund të pranohet në tersi, si plotësisht si i drejtë dhe i ligjshëm sepse sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate mbi gjendjen e tillë faktike, gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale kur gjykata e shkallës së parë ka refuzuar detyrimin kontraktues për emisionet e prodhuara por të pa transmetuara, sepse gjykata e shkallës së parë vendimin e saj për mos pranimin e detyrimit kontraktues në shumën prej 408,969.60 euro për emisionet e prodhuara nga paditësi sipas kontratës mbi emetimin televiziv, gjatë kohës sa e njëjta ishte në fuqi me të paditurin, emisione këto të pa – transmetuara në mënyrë të njëanshme nga i padituri, nuk e ka mbështetur në provat relevante dhe faktet vendimtare lidhur me këtë çështje, gjë që ka ndikuar në interpretim të gabuar edhe të dispozitave ligjore të LMD-së.

Sipas padisë, përgjigjes në padi, provave të administruara, deklaratimeve në seanca gjyqësore dhe deklaratimeve ankimore, kolegji i kësaj gjykate, ka gjetur si jo kontestuese faktet si në vijim, se:

1. palët ndërgjyqëse me datë 30.08.2010, kanë lidhur kontratë mbi emetimin televiziv e lidhur ndërmjet Radio Televizionit të Kosovës në cilësinë e emetuesit dhe Grand Media në cilësinë e shtëpisë prodhuese, nga e cila rezulton se palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje për bashkëpunim afarist me qëllim të emetimit të emisionit “Kush do të bëhet Milioner”, në kanalin RTK, për periudhën kohore prej datës 14.02.2011 deri me datën 13.02.2016. tutje palët me këtë kontratë janë marr vesh që emisioni ‘*Kush do të bëhet Milioner*’, do të emitohej ekskluzivisht në kanalin RTK për territorin e Kosovës, me anë të emisioneve tokësore ose nëpërmes programit satelitor ose kabllovik. Po ashtu me këtë kontratë është përcaktuar që emisioni do të emitohej ekskluzivisht edhe në një kanal televiziv në Shqipëri dhe në Maqedoni vetëm për territoret e tyre. Nga kjo kontratë rezulton se palët janë marr vesh që çmimi për një episod është në shumën e garantuar prej 14,690.00 € + TVSH-ë.
2. se paditësi N.SH. “Grand Media” në cilësinë e shtëpisë prodhuese dhe Agron Llaka në cilësinë e moderatorit me datën 30.08.2010, kanë lidhur kontratë për bashkëpunim, me qëllim të moderimit të emisionit “Kush do të bëhet Milioner”, për periudhën pesë vjeçare nga muaji Janar i vitit 2011 deri në muajin Janar të vitit 2016, ku paga e moderatorit-

drejtuesit të emisionit në fjalë është përcaktuar në vlerën prej 5,000.00 €, për një muaj të plotë kalendarik.

3. paditësi me datë 01.03.2011 ka lidhur edhe kontratën me subjektin juridik “Frutex” SH.P.K., e nga e cila rezulton se palët kontraktuese kanë arritur marrëveshje për bashkëpunim afarist me qëllim të sponsorizimit (reklamimit) të produktit Golden Eagle të Kompanisë Frutex SH.P.K., në emisionin “Kush do të bëhet Milioner”, në vlerën prej 68,200.00 € në vit, për periudhën prej datës 01.03.2011 deri me datën 31.12.2015.
4. se gjatë periudhës kohore nga data 01.03.2011 deri me datën 01.06.2012, nga paditësi për të paditurin janë realizuar gjithsej 63 emisione “Kush do të bëhet Milioner”, për të cilat emisione, nga vlera e faturimeve rezulton se i padituri i ka paguar paditësit shumën prej 1,040,616.46 €, duke i mbetur borxh në emër të faturave edhe shumën prej 32,933.54€.
5. se, nuk është kontestues detyrimi kontraktues i mbetur në emër të faturave për emisionet e transmetuara në shumën prej 32,933.54 €, ngase kjo pohohet edhe në ankesën e të paditurit dhe se e njëjta rrjedhë edhe nga pasqyra financiare të të paditurës.
6. se duke filluar nga qershori i vitit 2012, drejtori i përgjithshëm i asaj kohe zt. S.Sh. vendosi të ndërpritet transmetimi i emisionit “Kush do të bëhet Milioner”, shif: vendimin nr. 0053/2/13 datë 26.04.2013, por se nuk ka veprime drejtë shkëputjes/ndërprerjes së kontratës mbi emetimin televiziv.
7. se këtu paditësi edhe pas kësaj date si në pikën 6 më lartë, duke mos pasur asnjë njoftim se do të ndërpritet/shkëputet kontrata, i njëjti ka vazhduar me prodhimin e emisioneve “Kush do të bëhet Milioner”, gjithsej 24 sosh, në vlerë të përgjithshme prej 408,969.60 euro, të konstatuara me ekspertizën financiare të datës 10.08.2016, të ekspertit financiar Riza Blakaj si dhe me super ekspertizën financiare të datës 30.09.2021 të punuar nga grupi i ekspertëve financiar Flamur Keqa, Remzi Smajli dhe Gresa Shabani, dhe plotësimin e saj të datës 20.02.2022.
8. se me datë 15.04.2013, e paditura ka nxjerr vendim me të cilin ka themeluar komision për vlerësimin e kontratave me producentët e jashtëm, në këtë rast edhe vlerësimin e kontratës së datës 30.08.2010 me subjektin këtu paditësin N.Sh. Grand Media me seli në Prishtinë, në përbërje prej: 1. B.H., 2. M.M., 3. M. L., 4. A.R.. dhe 5. M.L.
9. se procesverbali i takimit “RTK – Grand Media”, i datës 17.04.2013 është i nënshkruar vetëm nga ana e procesmbajtëses N.N. – zyrtare e Administratës dhe Burimeve Njerëzore në RTK 1 – Tv, dhe i cili ka nxjerrë konkluzion që: komisioni i cili ka qenë në përbërje prej B.H.. – u.d. Drejtor i RTK-së; M.L.. – Kryeredaktor në RTK, M.M.- Udhëheqës i

Shërbimeve të Përbashkëta në RTK, A.R.. u.d. Zv. Drejtoreshë e Përgjithshme (e cila nuk ka qenë prezent në takim), M.L.. – Zyrtare ligjore 1 në RTK, kanë propozuar që obligimet në vlerë prej 357.390.00 € të shlyhen dhe të shkëputet kontrata me “Milionerin”, për shkak të situatës financiare, të bëhet negociimi për bendet e reja, emisionet e reja nga Grand Media dhe se Grand Media nuk pajtohet me shkëputjen e kontratës.

10. se pas gjitha këtyre si më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së në atë kohë, zt. Mentor Shala, ka marr vendimin e datës 19.04.2013 Nr.prot 0053/2/13 i datës 26.04.2013, nga i cili rezulton se bazuar në aspektin financiar, deri në një shqyrtim të qartë ligjor të pezullohet kontrata dhe të mos pranohen faturat e dërguara nga ana e Kompanisë Grand Media, për transmetimin e emisionit “Kush do të bëhet Milioner”.

Kolegji i kësaj Gjykate, vlerëson se në rastin konkret kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse mbetet nëse kontrata e lidhur është shkëputur në mënyrë të kundërligjshme nga ana e të paditurit dhe si rrjedhojë nëse përgjegjësia për kompensimin e dëmit nga mos përmbushja e kontratës bie në barrë të paditurit, respektivisht nëse ekziston baza ligjore e kompensimit të detyrimit kontraktues, sipas kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit ”kush do të bëhet milioner”, dhe dispozitave të LMD-së.

Nga shkresat e lëndës evidentohet se e paditura me pasqyrat financiare, respektivisht me kartelën e partneritetit për vitin 2015, si dhe me pohimet e bërë edhe në ankesë, është evidentuar qartë dhe është pranuar se shuma prej 32,933.54 euro ka mbetur detyrim i të paditurit Radio Televizioni i Kosovës për këtu paditësin N.SH. Grand Media për emisionin Milioneri, andaj edhe kjo çështje nuk do të eleborohet ma shumë ngase edhe kolegji i Kësaj Gjykate këtë detyrim kontraktues tani më e konsideron si jo kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse.

Duke vlerësuar besueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se në zgjidhjen e çështjeve kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, e në veçanti të çështjes lidhur me fitimin e humbur nga mos përmbushja e kontratës Mbi emetimin televiziv, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar gjendjen faktike ashtu sikurse ka zbatuar në mënyrë të drejtë edhe dispozitat materiale lidhur me këtë çështje, ngase ky qëndrim i gjykatës së shkallës së parë derivon nga vetë neni 14 i kontratës mbi emetimin televiziv, në të cilën kontratë është përcaktuar shprehimisht se: në rast se njëra palë ndërprente bashkëpunimin njëanshëm pa ndonjë arsye të mos respektimit të kësaj marrëveshje atëherë si dëmshpërblim duhet të paguaj

shpenzimet pesë (5) mujore, dhe nga interpretimi i drejtë i kësaj dispozite ligjore, paditësi ka pasur të drejtën që në mënyrë alternative të kërkojë përmbushjen e kontratës, pagesën e dënimit kontraktues apo shpërblimin e dëmit, ndërsa nuk i njihet e drejta për të kërkuar në mënyrë kumulative edhe përmbushjen e kontratës edhe dënimin kontraktues si dhe kompensimin e dëmit, ashtu siç ka kërkuar më kërkesëpadi.

Për më tepër edhe kolegji i kësaj gjykate vlerëson se këto qëndrime të Gjykatës së shkallës së parë sa i përket fitimit të humbur kanë mbështetje juridike në dispozitat e LMD-se, e ku në nenin 273 të LMD-së, shprehimisht thuhet se *“Kur dënimi është kontraktuar për rastin e mos përmbushjes së detyrimit, kreditori mund të kërkojë ose përmbushjen e detyrimit ose dënimin kontraktues. Ai e humb të drejtën për të kërkuar përmbushjen e detyrimit në qoftë se ka kërkuar pagimin e dëmit të kontraktuar”*. Madje edhe sipas dispozitës së nenit 629 të LMD-së, në rast të kontraktimit të shpërblimit për shkak të kontratës, ashtu siç është përcaktuar decidivisht në nenin 14 të kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit “kush do të bëhet milioner”, paditësi ai ka të drejtën të kërkojë vetëm pagesën e shpërblimit të kontraktuar, por jo në mënyrë kumulative edhe fitimin e humbur ngase në të kundërtën do të shkelej kushti parimor që të mos ketë dyfishim të kompensimit për të njëjtën çështje.

Për Kolegjin e dhomave të shkallës së dytë është i qartë fakti se mes palëve ndërgjyqëse nuk ka pasur paqartësi në zbatim të kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit “kush do të bëhet milioner”, deri më datë 01.05.2012, kjo për faktin se marrëdhënia juridike sipas kësaj kontrate është përmbushur në tersi, përjashtimisht detyrimi i mbetur prej 32,933.54 euro për faturat e pa-paguara për emisionet e transmetuara dhe e cila shumë tani më nuk është kontestuese, ngase është pranuar si e tillë me kartelën e furnitorit të vitit 2015, dhe është pohuar nga e paditura edhe në ankesë.

Po ashtu për kolegjin e kësaj gjykate është i qartë edhe fakti tjetër se nga qershori i vitit 2012, ndonëse është marrë vendim nga Drejtori i përgjithshëm i RTK-së në atë kohë për ndërprerjen e transmetimit të emisionit “Milioneri”, ky vendim sipas kontratës respektivisht, nenit 14, duhet të kishte vetëm efekt të përkohshëm dhe se i njëjti në asnjë rast nuk ka pasur edhe efekt suspensiv në kuptim të mos-prodhimit të emisioneve nga këtu paditësi.

Për më tepër Kolegji vlerësoj edhe njëherë veprimet e të paditurës në raport me detyrimet kontraktuese, gjithmonë sipas kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit “kush do të bëhet

milioner”, në fuqi në atë kohë, e cila kontratë ndonëse e kishte paraparë si mundësi që *emituesi RTK është televizioni publik dhe nuk është i garantuar me buxhet financiar afatgjatë, dhe në rast se RTK vjen me ndonjë problem kur ndërpriten totalisht të hyrat financiar atëherë RTK për këtë periudhë nuk merr përsipër obligimet ndaj Shtëpisë Prodhuese, Emituesi merr për obligim të njoftojë me shkrim Shtëpinë Prodhuese dhe në këtë rast palët mund të marrin një vendim për ndërprerje të emitimit vetëm gjatë kohës sa RTK nuk ka të siguruar buxhetin financiar, kjo mund të bëhet menjëherë me Aneks Kontratë. Palët Kontraktuese me marrëveshje, konstatojnë që me këtë kontratë të konkretizojnë bashkëpunimin afarist lidhur me prodhimin me emetimin e emisionit lëndor në këtë kohë të caktuar për periudhën nga 14 Shkurt 2011 deri 13 Shkurt 2016, e paditura asnjëherë këto veprime të saja nuk i ka formalizuar më një aneks kontratë siç është kërkuar, andaj edhe prodhimet e paditësit në kuptim të sigurimit të emisioneve për transmetim në të ardhmen brenda afatit të vlefshmërisë së kontratës konsiderohet si prodhime brenda kontratës në fuqi mbi emetimin televiziv të emisionit ”kush do të bëhet milioner”, dhe për të cilat e njëjta më të drejtë ka lëshuar faturat përkatëse dhe i ka përcjellë tek e paditura, edhe pse kjo e fundit ka refuzuar pranimin e tyre, mirëpo kolegji vlerëson se refuzimi i pranimin të këtyre emisioneve të prodhuara dhe të faturave përkatëse nuk e liron të paditurin nga përgjegjësia për pagim të këtij detyrimi që rrjedh nga detyrimi kontraktues, ngase sipas LMD-së, borxhi përfaqëson një detyrim juridik që lind nga një marrëdhënie detyrimore, ku njëra palë debitori është e obliguar të përmbushë një detyrim ndaj palës tjetër kreditorit.*

Kolegji vlerëson se kontrata është e tillë ashtu që interpretimi i kontratës nuk mund të bëhet duke e favorizuar hapur njërën palë pa marrë parasysh nëse e njëjta thirret në interesin publik, në mënyrë që përmes interpretimit më të favorshëm të dëmtohet pala tjetër. Prandaj, Kolegji vlerëson se nëse i referohemi fakteve se me datë 15.04.2013, e paditura ka nxjerr vendim me të cilin ka themeluar komision për vlerësimin e kontratave me producentët e jashtëm, në këtë rast edhe vlerësimin e kontratës së datës 30.08.2010 me subjektin këtu paditësin N.Sh. Grand Media me seli në Prishtinë, se procesverbali i takimit “RTK – Grand Media”, i datës 17.04.2013 ka nxjerrë konkluzion që obligimet e RTK-së ndaj N.Sh. Grand Media në vlerë prej 357.390.00 € të shlyhen dhe të shkëputet kontrata me “Milionerin”, ky fakt mjaftueshëm mund të merret si njoftim për shkëputjen e kontratës nr. 1283/11, dhe në referim edhe të vendimit të datës 19.04.2013, Nr.prot 0053/2/13 i datës 26.04.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së rezulton qartë se kemi ndërprerje të njëanshme të bashkëpunimit nga RTK-ë në raport me subjektin N.Sh. Grand Media, e me këtë edhe krijimin e bazës për rregullimin e pasojave nga marrëdhënia e tillë detyrimore për palën tjetër.

Me Nenin 124 të LMD-së, përcaktohet se: *“për kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushte parashikuara në nenet e më pastajme, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë në qoftë se zgjidhja e kontratës lind sipas vetë të drejtës, e sidoqoftë ka të drejtë t'i kompensohet dëmi.”*

Dhoma e Shkallës së Dytë nuk mund të pajtohet me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se paditësi ka kontribuar në çfarëdo forme që dëmi të krijohet ose te jetë më i madh nga sa do të ishte zakonisht ngase gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se palët kanë lidhur kontratën e bashkëpunimit nr. 1283/11, me afat pesëvjeçar, nga data 14.02.2011 deri më 13.02.2016, e sipas së cilës paditësi ishte i obliguar të prodhonte për të paditurin një emision në javë, ndërsa I padituri ishte i obliguar të paguante shumën prej 17,040.00 € me TVSH-ë, për secilin emision të realizuar. Tutje sikurse gjykata e shkallës së parë edhe kolegji njëjtë ka gjetur se kontrata mbi emetimin televiziv të emisionit “kush do të bëhet milioner” është zbatuar për një periudhë prej më shumë se një (1) viti, dhe atë deri më datë 01.06.2012, pas së cilës i padituri e ka ndërprerë njëanshëm dhe pa shkak të arsytuar transmetimin e emisionit “Milioneri”, dhe përfundimisht me datë 16.07.2013 e ka ndërprerë përfundimisht bashkëpunimin, duke mos i pranuar dhe as paguar 24 emisione të prodhuara nga paditësi, me vlerë totale sikurse në super ekspertizë financiare.

Në këto rrethana, kolegji ka vlerësuar se për prodhimet e kryera dhe të pa-transmetuara, e në veçanti nga provat e dorëzuara me parashtresat e datës 01.06.2023, 21.06.2023, dhe faturat e bashkangjitura, paditësi ka të drejtë të kërkojë pagesën e detyrimit të rrjedhur nga kontrata, pasi detyrimi financiar në shumën prej 408,969.60 euro ka lindur nga marrëdhënia kontraktuale për punë të përfunduara dhe të pa-paguara.

Në një gjendje të këtillë të fakteve, Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të konstatojë drejtë gjendjen faktike lidhur me detyrimin kontraktues për shumën prej 408,969.60 euro, specifikisht lidhur me emisionet e prodhuara sipas kontratës në fuqi por të refuzuara nga i padituri dhe të pa – transmetuara dhe rrjedhimisht kjo gjendje ka sjellë edhe që e drejta materiale të mos zbatohen drejtë në këtë pikë, pra atëherë kur nuk i ka njohur si detyrim edhe shpenzimet nga emisionet e prodhuara por të refuzuara nga RTK-ë dhe të pa transmetuara.

Ndërsa për periudhën e mbetur të kontratës, dhe atë pas datës së ndërprerjes, edhe kolegji pajtohet me vlerësimin e Gjykatës së shkallës së parë se paditësi ka të drejtë të kërkojë kompensimin e shpenzimeve 5 mujore si dënim kontraktues - penalitet ashtu siç parashihet edhe me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, për shkak se ndërprerja e njëanshme dhe e pajustificuar i ka shkaktuar bazën për kërkimin e të njëjtave, paditësit. Sipas nenit 154 të LMD-së, përcaktohet se *“ai që shkakton dëmin, është i detyruar ta kompensoj atë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*.

Nga fakti se në shkresat e lëndës dhe bazuar edhe në super ekspertizën financiare të datës 30.09.2021 për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë mbi gjendjen faktike të tillë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur nuk e ka njohur si detyrim kontraktues edhe shumën prej 408,969.60 euro për emisionet e prodhuara sipas kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit *“kush do të bëhet milioner”* në fuqi, e të pa transmetuara dhe kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit në këtë pjesë është refuzuar, andaj është dashur që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të gjykohet edhe në këtë pjesë sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimeve ankimore të të paditurës lidhur me gjendjen faktike, respektivisht pretendimit se e njëjta është në kundërshtim me ligjin bazik që rregullon fushë veprimtarinë e Radio televizionit të Kosovës, pra ligjit nr. 04/L-046, është në kundërshtim edhe me frymën e Kushtetutës, e cila përkon në mënyrë të qartë me nenin 119 paragrafi 3, se *“veprimet që e kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj”*, pra se gjykata gjatë vendosjes lidhur me këtë çështje juridike, nuk ka marrë për bazë fare obligimin kushtetues dhe ligjor të lartpërmendur, kolegji i kësaj Gjykate, gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse nuk kanë asnjë ndërlidhje me rastin konkret përderisa veprimet e palëve ndërgjyqëse në këtë rast derivojnë nga kontrata mbi emetimin televiziv të emisionit *“kush do të bëhet milioner”*, dhe se bazuar në dispozitat ligjore nga nenet 15 dhe 17 të LMD-së, palët kontraktuese në marrëdhënie kontraktuese janë të obliguara t'i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjëse lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke. Ndërsa sipas nenit 154 të LMD-së, përcaktohet se *“ai që shkakton dëmin, është i*

detyruar ta kompensoj atë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”. Po ashtu sipas Nenit 3, paragrafi 3.1, të LPK-së, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko-civile që i kanë para-shtruar gjatë procedurës, dhe se veprimet e palëve në rastin konkret në asnjë rrethanë nuk bien ndesh me nenin 119, par 3 të ligjit 04/L-146 por as me kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Tutje, sa i përket pretendimit tjetër ankimor të të paditurës lidhur me gjendjen faktike, respektivisht pretendimit se e gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke ia falur besimin super ekspertizës sa i përket dëmit dhe fitimit të humbur në shumën e cekur përderisa ekspertja Gresa Shabani gjate deklarimeve në seancë nuk e bën të besueshme pretendimin e saj, as kjo nuk qëndron ngase kolegji vlerëson se këto shuma derivojnë nga shkresat e lëndës dhe se të njëjtat kanë mbështetje në provat e administruara. Shuma prej 408,969.60 euro rrjedh nga 24 emisionet e përgatitura për të paditurin, sipas kontratës nr. 1283/11, e të pa transmetuara, tregojnë se paditësi nuk ka qenë i lajmëruar për ndonjë shpërndarje të Kontratës ndërsa fakti se detyrimi i mbetur nga emisionet e transmetuara në shumë prej 32,933.54 € nuk është mohuar as nga i padituri, e cila në deklaratimet e saj, arsyetohet se mos pagesa e detyrimit ka të bëjë me vështirësitë financiare, nuk paraqet arsyetim ligjor për mos pagesë. Përderisa shuma prej 373,741.54 euro rrjedh nga neni 14 i kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit ”kush do të bëhet milioner”.

Pretendimin tjetër ankimor i të paditurës që ka të bëjë me deklaratimin se : e paditura për shkak të ndryshimeve ligjore dhe gjendjes financiare nuk ka mundur të përmbushë detyrimin e kontraktuar për shkak të rrethanave të krijuara pas lidhjes së kontratës, kolegji i kësaj gjykate pretendimin e tillë ankimor e vlerëson si krejtësisht të paqëndrueshëm ngase përderisa është evidend fakti se e paditura mund të vie në gjendje të vështirësisë financiare, kjo situatë si e tillë është e paraparë edhe me nenin 14 të kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit ”kush do të bëhet milioner”, ku shprehimisht thuhet se : *Shtëpia Prodhuese pajtohet : Emituesi RTK është televizioni publik dhe nuk është i garantuar me buxhet financiar afatgjatë, dhe në rast se RTK vjen me ndonjë problem kur ndërpriten totalisht të hyrat financiar atëherë RTK për këtë periudhë nuk merr përsipër obligimet ndaj Shtëpisë Prodhuese, Emituesi merr për obligim të njoftojë me shkrim Shtëpinë Prodhuese dhe në këtë rast palët mund të marrin një vendim për ndërprerje të emitimit vetëm gjatë kohës sa RTK nuk ka të siguruar buxhetin financiar, kjo mund të bëhet menjëherë me Aneks Kontratë. Palët Kontraktuese me marrëveshje, konstatojnë që me këtë kontratë të konkretizojnë bashkëpunimin afarist lidhur me prodhimin me emetimin e emisionit lëndor në këtë kohë të caktuar për periudhën nga 14 Shkurt 2011 deri 13 Shkurt 2016, mirëpo*

edhe përkundër kufizimeve si më lartë e paditura asnjëherë nuk e ka bërë të ditur se të hyrat financiare për RTK-në në atë kohë janë ndërprerë totalisht, dhe edhe sikur të ishin ndërprerë totalisht këto të hyra atëherë emituesi – RTK-ë, është dashur të njoftojë me shkrim shtëpinë prodhuese N.Sh. Grand Media, dhe në këtë rast palët mund të ishin marrë vesh për ndërprerje të emitimit vetëm gjatë kohës sa RTK nuk ka të siguruar buxhetin financiar, dhe kjo është dashur të bëhet menjëherë me Aneks Kontratë, e ku në këtë aneks kontratë, palët kontraktuese me marrëveshje, konkretizojnë bashkëpunimin afarist lidhur me prodhimin dhe emetimin e emisionit lëndor në këtë kohë të caktuar për periudhën nga 14 Shkurt 2011 deri 13 Shkurt 2016, mirëpo RTK-ë është mjaftuar vetëm me veprime të njëanshme duke rënë kështu në shkelje të dispozitave kontraktuese.

Tutje ndryshimi i Ligjit për RTK-në, nuk e bën të pavlefshme kontratën, meqenëse këto ndryshime nuk prekin në elementet thelbësore të kontratës, përkatësisht objektin e kontratës. Kjo për faktin që neni 5 i Ligjit për RTK-në, nuk e ndalon blerjen e produksioneve të jashtme, mirëpo vetëm përcakton se *"Transmetimi i prodhimeve të pavarura që paguhet nga mjetet e RTK-së, përjashton çfarëdo lloj reklame apo sponsorimi"*. Ndërsa nëse analizohet kontrata me nenin 5 të saj është rregulluar hapësira publicitare dhe mënyra e sponsorizimit.

Kolegji vlerëson si jo të bazuar pretendimin ankimor të të paditurit lidhur me qasjen në drejtësi, kjo ngase e paditura gjatë gjithë rrjedhës së kontestit ka shfrytëzuar të gjitha të drejtat për pretendimet e ngritura përfshirë edhe nxjerrjen e provës me super ekspertizë financiare, përderisa për deklaratimet e saja referuar shkeljeve eventuale të kontratës mbi emetimin televiziv të emisionit "kush do të bëhet milioner", nga paditësi në asnjë pazë të procedurës nuk ka paraqitur apo bërë kundërpadi, por vetëm është mjaftuar me deklaratime dhe arsyetim të pretendimeve të ngritura.

Kolegji bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, në kontratën mbi emetimin televiziv të emisionit "kush do të bëhet milioner" dhe dispozitat e LMD-së, përfundimisht ka vlerësuar se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar andaj të njëjtën e ka aprovuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lartësinë e kompensimit, Gjykata e ka përcaktuar nga super ekspertiza financiare e datës 30.09.2021, e punuar nga grupi i eksperteve në përbërje prej 1. Flamur Keqa, 2. Remzi Ismajli dhe 3. Gresa Shabani . me të cilën është konstatuar që ndëshkimi kontraktual - penaltitetet për

shpenzimet pesë mujore të paditësit sipas nenit 14 të kontratës arrin në vlerën prej 340.808,00€, detyrimi kontraktues i mbetur në emër të faturave të pa paguara për emisionet e transmetuara nga e paditura arrin në vlerën prej 32,933.54 €, ndërsa detyrimi kontraktues i mbetur në emër të faturave të pa paguara nga e paditura për emisionet e prodhuara por të pa transmetuara arrin në vlerën prej 408,969.60€, ku në total detyrimi dhe ndëshkimi kontraktues - penalitetet arrijnë në shumën prej 782,701.54 €, të cilës super ekspertizë kolegji ia fali besimin sepse konstatimet e grupit të ekspertëve përputhen në tërësi edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata duke iu referuar nenit 277 të LMD-së (1978) i aplikueshëm për detyrimet që kanë lindur para datës 20.12.2012, e miratoi kamatëvonesën e kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç shumës në emër të ndëshkimit dhe detyrimit kontraktues, paditësit t'ia paguajë edhe kamatën ligjore siç e paguajnë bankat komerciale të Kosovës, për deponimet prej një viti, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedh nga dita e ushtrimit të padisë, gjegjësisht data 28.05.2014, e deri në pagesën definitive, pasi raporti detyrimor në rastin konkret është krijuar para datës 20.12.2012, andaj nuk aplikohet dispozita nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr. 04/ L-077) ashtu siç ka kërkuar paditësi.

Kolegji e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit mbi shumën e gjykuar dhe ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit mbi shumën e aprovuar është e pabazuar në ligj. Po ashtu kolegji nuk e ka marr parasysh plotësimin e ekspertizës financiare të grupit të ekspertëve të datës 20.02.2022, meqenëse në rastin konkret gjykata paditësit ia ka njohur të drejtën e ndëshkimit kontraktual - penaliteteve, vetëm për shpenzimet pesë mujore të përcaktuara në nenin 14 të Kontratës, e të cilat kanë qenë të llogaritura në super ekspertizën financiare të datës 30.09.2021 të punuar nga grupi i ekspertëve, si dhe të detyrimit kontraktor si borxh për shkak të pagesave të pa kryera për punën e përfunduar. Duke marr për bazë që plotësimi i super ekspertizës financiare i punuar nga grupi i ekspertëve i datës 20.02.2022, ka pasur të bëjë me llogaritjen e dëmit si fitim i humbur duke filluar nga data 01.05.2012 e deri në përfundim të kontratës me datën 13.02.2016, kolegji i kësaj gjykate të njëjtën nuk e ka marr parasysh, pasi që nga gjendja faktike e vërtetuar, ka konstatuar që paditësit i takon e drejta e kompensimit të ndëshkimit kontraktual - penaliteteve, vetëm sa i përket periudhës pesë mujore të përcaktuar si dënim kontraktues, dhe të detyrimit kontraktor si borxh për shkak të pagesave të pa kryera për punën e përfunduar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi dhe atë për përfaqësim në 13 seanca të mbajtura, në shumën prej 5492.50 € (422.50 € x 13) dhe për 4 seanca të shtyra, shumën prej 847 € (211.50 € x 4), në emër të pagesës për ekspertizën financiare shumën prej 300 € si dhe në emër të përpilimit të ankesës shumën prej 325 € x 2, gjithsej shumën totale prej 7,251.50 €.

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 195.1 pika e) dhe 201 pika b) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1562/24, datë 16.10.2025

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari

Fisnik NULI